



## Njoftim Publik

Në komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr.350/02-151677/24 dt. 14.11.2024 në emër të aplikuesve Xhevat Rafuna, Xhevdet Rafuna, Nuha Rafuna, Emin Rafuna, Fatmir Baholli dhe Daut Baholli, me investitor “LAN PREMIUM”, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesave shumëbanesore dhe afariste Lamella 1, me etazhitet 2B+S+P+5, Lamella 2, me etazhitet 2B+S+P+5, Lamella 3, me etazhitet 2B+P+5, Lamella 4, me etazhitet 2B+P+6, Lamella 5, me etazhitet 2B+P+5+PH, Lamella 6, me etazhitet 2B+P+5+PH dhe Lamella 7, me etazhitet 2B+P+5+PH, në kuadër të Planit Rregullues Zona Ekonomike dhe PZHU në Prishtinë, në kuadër të parcelave kadastrale nr.1383-2, 1384-2, 1385-6, 1385-7, 1385-9 Z.K.Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 17.01.2025 deri më 31.01.2025, në e-mail adresën: [urbanizimprishtine@rks-gov.net](mailto:urbanizimprishtine@rks-gov.net)

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesa shumëbanesore dhe afariste me etazhitet maksimal 2B+P+6
b. Vija rregulluese	Sipas Planit Rregullues – Zona Ekonomike
c. Vija ndërtimore	Sipas Planit Rregullues0 – Zona Ekonomike
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	22m/5m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	22m/11.00m’ anësore 19.00/12.91 anësore 22.00/ sipas vijës ndërtimore
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP – 0.4, 4642.2 m2 e lejuar, 4050.9 m2 e propozuar
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ – 0.4, 4655m2 \ 40.1%
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN – 1.8, 25068.96m2 e lejuar, 25068.96m2 e propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISN – 0.6, 6963.6m2 e lejuar 6948.81m2 e projektuar
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	342 vendparkingje nëntokësore, 17 vendparkingje mbitokësore
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Fasadë e ventiliuar
m. A ka qasje te pakufizuar ne rruge publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do te gjenerojë ndotje te mjedisit apo zhurmë me te madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore ne Zona te Mbrojtura, Zona te veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari: